

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

***“Mirembajtje Hidrovori”***

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**50000000 - 5**

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**3 831 333 (tre milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre)lekë pa TVSH.**

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, ka bërë përlogaritjen e vlerës limit të kontrates për kete procedure.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Operatori ekonomik duhet të disponojë Liçencat profesionale lidhur me ekzekutimin e shërbimeve objekt prokurimi, të vlefshme në momentin e hapjes:

- NS-10 punime për ndertimin, mirëmbajtjen dhe rikonstrukcionin e veprave hidraulike.
  - NS -16 Punime mekanike dhe elektro mekanike në impiante industriale.
- 

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e licenses “N.P janë përcaktuar në përputhje me shërbimet që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licenca profesionale për këto kategori.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024, ku Vlera e xhiros minimale vjetore që kërkohet nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të*

*operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.2.2.**Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:***Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”.*

**2.2.3** Vërtetimi të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2025 në të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

**Argumentimi:***Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.**

## 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40 % të vlerës së fondit limit. Përvoja e mëparshme është një element i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 Saldator oksigjenist për të cilin duhet të dorëzojë:

- Kontrate individuale të punës.
- Listëpagesat për muajin aktual

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë **personelin mekanik të nevojshëm për realizimin e kontratës**, në përbërje të të cilit të ketë **minimalisht 3 (tre) punonjës**.

Për të vërtetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij personelin mekanik për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës.

- Listëpagesat për muajin aktual

**Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.**

**Shënim:** Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit ofertuesi fitues që të dorëzojë kontratat individuale te punës.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin mekanik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës pasi nepermjet këtij stafi OE do beje te mundur realizimin me sukses te kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Gjithashtu, në lidhje me disponueshmërinë e stafit teknik tëkualifikuar, ky kriter është vendosur duke marrë në considerate natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit, me qëllim permbushjen me sukses te kontrates shfaqet e nevojshmeqe OE te kete te punësuar të paktën stafin e mesiperm,

Për këtë arsye disponueshëmeria e kërkesave të mësipërme janë në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit duke përmbushur synimin e kërkuar (garantimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me termat e referencës, kryerjen e shërbimit nga operatorë të kualifikuar e cila lidhet drejtpërdrejt rendesine e vecante te objektit te prokurimit).

2.3.4.Operatori ekonomik duhet të disponoje minimalisht 1 (një) kamioncine me kapacitet minimumi 3 ton.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë perkatese sipas formatit te meposhtem:

| Nr. | Lloji i mjetit | Targa | Kapaciteti mbajtes | Statusi               |
|-----|----------------|-------|--------------------|-----------------------|
| 1   |                |       |                    | Pronesi/qira/perdorim |
|     |                |       |                    |                       |

Per permbushjen e kesaj pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nepermjet Sistemit Elektronik te Prokurimeve dokumentacion provues si me poshte:

Per mjetin transportues (pronesi / qera / huapardorje) duhet te paraqese:

- Lejen e qarkullimit
- Kolaudimin
- Siguracionin
- Certifikaten e pronesisë ose kontraten e qerases / huapardorjes.

**Mjeti që do të deklarohet detyrimsht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.**

### **Shënim :**

Operatorët ekonomikë për mjetin që disponojne duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentat që vërtetojnë që vërtetojnë pronësinë, qiramarrjen, huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi:. Ky kriter është vendosur ne baze të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të se cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojne mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **SPECIFIKIME TEKNIKE**

**1) Pompa Ganz500 me prurje  $Q=5.5m^3/s$  dhe me fuqi  $N=440kë$ , dhe pompat e vogla me prurje**

**$Q=2.4m^3/s$  dhe  $H=6.15m$ .**

**Shërbimet për ndërrimin e pjesëve , riparimin pjesëve apo të difektuara do te behen me pjese origjinale dhe jo pjese te modifikuara apo te riparuar.**

Te gjitha të dhënat për pjesët e pompave sipas preventivit, duhet të kontrollohen nga subjekti fitues së bashku me personelin inxhinjero-teknik të A.K ( për cdo pjesë , të pompave, për cdo seksion kabëll elektrik , bullonat lidhës të pjesëve të pompave) për të patur sipas projektit të pompave në vend gjatë punës së riparimit të pompave mallrat dhe prodhimet e pjesëve që do të përdoren për riparimin e difekteve të cilat ofrohen nga operatori ekonomik do të jenë me një garanci jo më pak se 6 muaj.

Kontrolli teknik i pajisjeve dhe pjesëve të reja apo të prodhuara do të bëhen në prezencën e përfaqësuesve të A.K.

Bullonat që do të përdoren për montim të pjesëve duhet të jenë sipas kërkesës inoxs dhe bullonat e tjerë duhet të jenë të klasës 8.8 me rezistencë të lartë në tërësi (EC3 ose 800 Mpa).

Boja për lyerjen e elementeve metalik duhet të jetë bojë me bazë solvent me cilësi të lartë.

Boja duhet të ofrojë mbrojtje të lartë të sipërfaqeve metalike të cilat janë të ekspozuara. Siperfaqet që do të lyhen duhet të jenë të pastra dhe pa praninë e yndyrirave , ndryshkut , kriperave.

**Argumentimi i specifikimeve teknike:** Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor mbi llojin e shërbimeve dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**

**Senada Ndini**

**Ing. Eduard Hila**

**Teuta Dano**